

Në bazë të nenit 3 paragrafit 1 alinejës 21 dhe nenit 13 nga Ligji për Qendrën Shtetërore të Provimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.142/08, 148/09, 41/14, 55/16, 142/16 dhe 64/18) në lidhje me nenin 32 dhe 33 nga Rregullorja për mënyrën e dhënies dhe vlerësimin të rezultateve të nxënësve në provimet për maturën shtetërore në gjimnaze, arsimin e mesëm profesional dhe të artit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.66/10, 63/12 dhe 159/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.65/21) dhe Kërkesës nr.10-374/1 nga 8.11.2022, drejtori i Qendrës Shtetërore të Provimeve shpall

K O N K U R S

për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm-anëtarë të Komisioneve Lëndore të Maturës Shtetërore

Qendra Shtetërore e Provimeve shpall konkurs për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm-anëtarë të Komisioneve Lëndore të Maturës Shtetërore për provimet e lëndëve:

- *Gjuhë maqedonase dhe letërsi - 7 anëtarë (një kryetar dhe gjashtë anëtarë);*
- *Gjuhë shqipe dhe letërsi - 6 anëtarë (një kryetar dhe pesë anëtarë);*
- *Gjuhë turke dhe letërsi - 4 anëtarë (një kryetar dhe tre anëtarë);*
- *Gjuhë angleze - 7 anëtarë (një kryetar dhe gjashtë anëtarë);*
- *Gjuhë frënge - 4 anëtarë (një kryetar dhe tre anëtarë);*
- *Gjuhë gjermane - 5 anëtarë (një kryetar dhe katër anëtarë);*
- *Gjuhë ruse - 3 anëtarë (një kryetar dhe dy anëtarë);*
- *Matematikë - 6 anëtarë a (një kryetar dhe pesë anëtarë);*
- *Filozofi - 3 anëtarë (një kryetar dhe dy anëtarë);*
- *Estetikë - 4 anëtarë (një kryetar dhe tre anëtarë).*

Kandidatët që konkurrojnë për **kryetarë** të Komisioneve Lëndore të Maturës Shtetërore, duhet të plotësojnë këto kushte:

- *të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;*
- *të kenë të kryer të paktën studime akademike të shkallës së dytë nga fusha përkatëse;*
- *të jenë nga radha e kuadrit arsimor-shkencor ose profesional nga universitetet në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga lënda/fusha përkatëse;*
- *të kenë të paktën 5 vjet përvojë pune në veprimtarinë edukative-arsimore ose shkencore;*
- *të kenë të botuara punime profesionale, gjegjësisht shkencore të cilat janë në funksion të fushës përkatëse.*

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- një kopje të shtetësisë;
- fletëparaqitje;
- biografi e shkurtër;
- një kopje të noterizuar të certifikatës/diplomës për arsimin e lartë përkatës
- një kopje të noterizuar të certifikatës/diplomës për arsimin e ciklit të dytë nga fusha përkatëse;

- në origjinal vërtetimin e përvijës së punës në veprimtarinë edukative-arsimore ose shkencore nga universitetet në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga lënda/fushe përkatëse;
- një kopje të ballinës së punimeve të botuara, përkatësisht punimeve shkencore që janë në funksion të fushës përkatëse.

Kandidatët që konkurrojnë për **anëtarë** Komisioneve Lëndore të Maturës Shtetërore, duhet të plotësojnë këto kushte:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të kenë të kryer të paktën studime akademike të shkallës së parë nga fusha përkatëse;
- të jenë nga radha e personave profesional-mësimdhënës nga lënda përkatëse mësimore në shkollat e mesme në RMV;
- të kenë të paktën 7 vjet përvijë pune në arsim;
- të kenë të paktën 3 vjet përvijë në procesin e vlerësimit të provimeve eksterne nga matura shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- nënshtetësinë;
- fletëparaqitjen;
- biografi e shkurtër;
- një kopje të noterizuar të certifikatës/diplomës për arsimin e ciklit të parë nga fusha përkatëse;
- në origjinal vërtetimin e përvijës së punës si mësimdhënës nga lënda mësimore përkatëse në shkollat e mesme në RMV;
- provë për përvijën në procesin e vlerësimit në provimet eksterne të maturës shtetërore (aktvendim, kontrat; ose vërtetim).

Kryetari dhe anëtarët duhet të kenë përvijë në përgatitjen e materialit të provimit.

Qendra Shtetërore e Provimeve do të bëjë seleksionimin sipas kriterëve të lartpërmendura, kurse kandidatët të cilët të do të hyjnë në rrethin e dytë do të intervistohen, më pas do të vijojë përzgjedhja përfundimtare.

Kandidatët të cilët do të përzgjidhen do të jenë të angazhuar për periudhë prej **dy vjetësh**.

Kandidatët e interesuar mund t'i dorëzojnë dokumentet e duhura **më së voni deri më 21.11.2022**.

Dokumentacioni jo i dërguar në kohë, jovalid dhe i pakompletuar, nuk do të merret parasysh.

Fletëparaqitja me dokumentacionin e duhur dorëzohet me anë të dërgesës së rekomanduar postare, në këtë adresë *Qendra Shtetërore e Provimeve – Shkup rr. "Vasil Gjorgov" p.n. 1000 Shkup*, me shënimin për **konkursin publik për anëtarë të komisionit lëndor të maturës**.

Informacione plotësuese mund të merren në numrin e telefonit 076/490-310 dhe 075/258-862, çdo ditë pune.

